



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 24 maj 2018**

**Numri i lëndës: 2017-06**

**Feriz Gashi**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 24 maj 2018, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 6 shtator 2017.
2. Ankuesi ka kërkuar që Paneli mos t'i bëjë publike të dhënat e identitetit të tij. Megjithatë, ai nuk ka ofruar ndonjë arsye që do ta mbështeste kërkesën e tij. Gjithashtu edhe Paneli nuk ka identifikuar ndonjë rrezik ndaj ankuesit që do të ngritej nga publikimi i identitetit të tij. Në lidhje me këtë, Paneli thekson që parashtuesi i ankesës më parë ka parashtuar një ankesë në Panel lidhur me procedurat e njëjta penale (lënda nr. 2011-22, *Hysni Gashi dhe Feriz Gashi kundër EULEX-it*) dhe atëherë nuk ka kërkuar që të mbetej anonim. Kështu ai

e kishte zbuluar identitetin e vet në lidhje me të njëjtat fakte që tani lidhen me ankesën e re. Duke pasur parasysh këto fakte, Paneli konstaton se kërkesa e tij që të jetë anonim është e pabazuar dhe vendos që mos ta pranoj atë.

## II. FAKTET

3. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi dhe siç paraqiten në dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### *Procedura penale ndaj ankuesit*

4. Me datën 22 prill 2006 dy persona kanë qëlluar për vdekje dy persona të tjerë dhe ishin përpjekur që të vrisnin disa persona të tjerë në tarracën e një kafeneje në komunën e Shtimes.
5. Më 10 janar 2007, ishte ngritur aktakuzë ndaj ankuesit nga prokurori publik në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ankuesi ishte njëri prej të dyshuarve në atë rast dhe se në bazë të kësaj ishte arrestuar.
6. Lënda ishte marrë përsipër nga EULEX-i Kosovë në dhjetor 2008, pas një kërkesë nga ankuesi. Deri atëherë ishin mbajtur tetë (8) seanca gjyqësore dhe ishte bërë një vizitë në vendin e ngjarjes.
7. Më 11 korrik 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori një vendim si në vijim:  
  
Arresti shtëpiak i ankuesit ishte zgjatur edhe për dy muaj të tjerë, pra deri më 11 shtator 2008.
8. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë para trupit gjykues në përbërje të dy gjykatësve të EULEX-it dhe një gjykatësi kosovar më 11 shkurt 2009. Pas kësaj, janë mbajtur edhe gjashtë (6) seanca të tjera gjyqësore.
9. Më 27 mars 2009, ankuesi ishte dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për vrasje të rëndë, nxitje për vrasje të rëndë dhe vepra të tjera penale.
10. Ai ishte dënuar me njëzet e pesë (25) vjet burgim.
11. Avokati i ankuesit ka parashtruar ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 14 korrik 2009. Në emër të tij kishte parashtruar që aktvendimi përmbante shkelje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, se kishte një vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve, se kishte shkelje të Kodit Penal të Kosovës dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit ishte i tepruar. Prandaj ishte propozuar që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

12. Palët e dëmtuara, E.F. dhe G.B., kanë paraqitur ankesa të ndara në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke e kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kohëzgjatjen e dënimit.
13. Më 19 prill 2011, ankesa e parashtruar në Gjykatën Supreme në emër të palëve të dëmtuara, E.F dhe G.B. ndaj vendimit për dënim të ankuesit të akuzuar ishte pranuar. Aktgjykimi në lidhje me ankuesin ishte ndryshuar, së pari në lidhje me veprën penale të vrasjes së rëndë, në një kohëzgjatje prej njëzet e nëntë (29) vjet burgim, dhe së dyti, në lidhje me veprën penale të posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve për të cilën ka marrë dy vite (2) vite burgim, e cila kishte rezultuar në një dënim të përgjithshëm prej tridhjetë (30) vjet burgim.

#### *Ankesa e mëparshme në Panel*

14. Më 30 qershor 2011, ankuesi së bashku me Hysni Gashin kanë parashtruar një ankesë në Panel.
15. Ankesa kishte të bënte me të njëjtat fakte të përgjithshme dhe me procedurat e njëjta penale si ato në të cilat është bërë ankesa në këtë lëndë. Megjithatë atëherë ankuesi nuk e kishte njoftuar Panelin lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
16. Të dy ankuesit pretendonin se procedura penale ndaj tyre ishte e padrejtë dhe se ata ishin dënuar gabimisht.
17. Më 23 nëntor 2011, Paneli mori vendimin lidhur me ankesën e mëparshme. Aty ishte konstatuar se ankesa ishte parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me Rregulloren e punës dhe pavarësisht nga kjo Paneli nuk kishte kompetencë që të shqyrtonte ankesën. Prandaj, Paneli e kishte shpallur ankesën të papranueshme (shih [Hysni Gashi dhe Feriz Gashi kundër EULEX-it](#), nr. 2011-22, 23 nëntor 2011).

### **III. ANKESAT**

18. Ankuesi pretendon se kryesuesi i trupit gjykues, një gjykatës i EULEX-it, kishte vepruar në mënyrë jo të duhur, se gjykata kishte marrë një vendim të paligjshëm, pavarësisht prej të gjitha dëshmive që çonin drejt pafajësisë së tij të pretenduar dhe se EULEX-i Kosovë i kishte mbështetur dhe mbrojtur kriminelët për interesat e veta.
19. Përderisa ankuesi nuk i referohet ndonjë të drejte themelore të caktuar, të cilën ai pretendon se ishte shkelur, duket nga përmbajtja e ankesës së tij se ai duhej t'i ishte referuar nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut/neni 14 i Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

#### IV. LIGJI

20. Para shqyrtimit të ankesës mbi bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendos nëse do të pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
21. Paneli së pari do t'i referohet fakteve dhe ankesave që kanë të bëjnë me procedurat para aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të datës 19 prill 2011. Theksohet se Paneli tashmë e ka shqyrtuar këtë pjesë të ankesës në lëndën nr. 2011-22 dhe se Paneli kishte marrë vendim të papranueshmërisë në lidhje me to. Ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë informacion të ri që do të arsyetonte rishqyrtimin e atij vendimi të Panelit. Nga kjo del se kjo pjesë e ankesës është në thelb e njëjtë sikurse çështja që tashmë është e shqyrtuar nga Paneli dhe duhet të shpallet e papranueshme në pajtim me rregullën 29, paragrafi 1(a) të Rregullores së punës së Panelit.
22. Sa i përket pjesës tjetër të ankesës, Paneli rithekson se sipas rregullit 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në Kosovë.
23. Sipas rregulloren të përmendur, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë, Paneli në parim nuk mund t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Kjo ankesë ka të bëjë me procedurat gjyqësore të kryera nga një gjykatë në Kosovë. Fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës. Paneli nuk ka juridiksion sa i përket aspekteve administrative ose gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës, legjislacionit të aplikuar prej tyre ose vendimeve të marra prej tyre. Vendimet e gjykatave të Kosovës i nënshtrohen apelimeve dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi (ndër të tjera shih *Shpresim Uka kundër EULEX-it*, 2016-06 & 2017-04, 17 tetor 2017, par. 22; *Z.A. kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 shkurt 2016, par. 17; *K.P. kundër EULEX-it*, 2014-31, 21 prill 2015, par. 13; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, par. 13). Po ashtu, vihet re se ankuesi në këtë rast ka shterur procedurat e ankimit në dispozicion të tij.
24. Rrjedhimisht, çështjet e ngritura në këtë ankesë nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë, siç është saktësuar në Rregullën 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.
25. Për më tepër, në pajtim me rregullën 25 (3) të Rregullores së punës së Panelit, ankesa duhet të parashtrohet në Panel brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së supozuar (shih p.sh. *Axhemi Zyhdë kundër EULEX-it*, 2016-05, 17 tetor 2017 par. 14-16; *Syla kundër EULEX-it*, 2015-10, 1 mars 2016, paragrafi 16).

26. Ankesa e Feriz Gashit në lidhje me aktgjykimin e datës 19 prill 2011 të Gjykatës Supreme është parashtruar në Panel më 6 gusht 2017, pra më shumë se gjashtë vite pas ngjarjeve përkatëse. Paneli konstaton se veprimi rreth të cilit është bërë ankesa nga ankuesi bie jashtë afatit gjashtë mujor, brenda të cilit ankesa duhet të parashtrohet në Panel sipas Rregullës 25(3) të Rregullores së Punës.

#### **PËR KËRO ARSYE, PANELI NJËZËRI,**

*konstaton* se pjesa e ankesës lidhur me faktet që i paraprijnë ankesës në Gjykatën Supreme të datës 19 prill 2011 në thelb është e njëjtë sikurse çështja që tashmë është e shqyrtuar nga Paneli, në kuptim të Rregullës 29, paragrafi 1(a) të Rregullores së Punës dhe ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj ndonjë arsye për rishqyrtimin e vendimit në përputhje me Rregullën 43(3);

*konstaton* se pjesa tjetër e ankesës është qartazi e pabazuar në kuptim të nenit 29, paragrafi 1(e) të Rregullores së Punës dhe se nuk është në përputhje me nenin 25(3) të Rregullores sa i përket afatit për paraqitjen e ankesës, dhe për këtë arsye

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese